



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

---

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 28.10.2019,  
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Agim Gashi, Jeta Rafuna, Eman Rahmani, Egzon Azemi Fadil Gashi, Vala Peshku, Halim Halimi, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Merita Maliqi përfaqësuese e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Fatos Osmani zyrtar nga Drejtoria e Arsimit, Eroll Raskova, udhëheqës i Sektorit të buxhetit dhe financave, Faton Ajeti, përfaqësues nga OSCE-ja dhe Qëndrim Arifi, përfaqësues nga INPO-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta, kryesues**.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Osman Bllaca propozoi që të futen si pika të rendit të ditës këto dy propozime: "Propozimvendimi për caktimin e lokacionit përvendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës përvendosjen e shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore". Propozimi i dyta është se Komuna e Prishtinës dëshiron të marrë kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, kredia është në shumë prej 5 milionë euro, për 10 vjetët e ardhshme duhet të bëhet kthimi i kredisë, e qëllimi i kredisë është përrregullimin e ndërtesave publike, që janë për ndërrimin e çative, përfiqencë, përfasada, përdritare etj.

**Agim Gashi** theksoi se nuk jemi kundër kredive, se është çështje kulturë standarde, mirëpo në vitin e ardhshëm do t'i kemi minimum 60 milionë € në dispozicion për investime kapitale, duke marrë parasysh sa janë bartur dhe sa i kemi planifikuar.

---

Faqe 1 nga 8



**Osman Bllaca** dha sqarime lidhur me këtë kredi, duke cekur se në aspektin finansiar dhe në aspektin procedural të Bankës Botërore për dhënien e një borxhi një shteti në këtë rast, ka shumë procedura që duhen bërë.

**Halim Halimi** lidhur me propozimin e Osmanit për me futur në rend dite marrjen e kredisë, për një kredi kaq të madhe, është dashur të vinte kryetari për të dhënë sqarime, por nuk kemi nevojë që Komuna të futet në kredi, sepse ne e dimë që Komuna ka para dhe po i mbesin paratë pa i shpenzuar. Andaj, unë kisha propozuar që kjo çështje të mos futet as në rend dite. **Fadil Gashi** u shpreh se për këtë kredi nuk ia vlen as të diskutohet në këtë mbledhje, për shkak se buxheti i Komunës së Prishtinës çdo herë po tepron.

**Sami Boroci** shprehu mendimin se nuk ka asgjë të keqe nëse ne e votojmë për me e futur si pikë të rendit të ditës, e diskutimin më detal e kishim bërë në Kuvend, sepse na duhen informata më të shumta. Ndoshta do të duhej të vinte kryetari me sqaruar më shumë se cila është ideja e këtij projekti dhe me vendosur në Kuvend.

**Eman Rahmani** u shpreh i pajtimit se si projekt është i mirë, mirëpo arsyetimi për marrjen e kredisë për realizimin e këtij projekt është i gabueshëm, sepse si kërkesë po shkon me u proceduar si kredi e jo si projekt, andaj nuk ka arsyet e shkojë si pikë e rendit të ditës. Ne mund ta dërgojmë si pikë të rendit të ditës si projekt, por jo si kërkesë për marrje të kredisë. **Vala Peshku** theksoi se këto si pika duhet të shkojnë përpara.

**Egzon Azemi** u shpreh se ky institucion ka marrë edhe një herë kredi nga BERZH-i për autobusë, ku është dashur kredinë me paguar NP "Trafiku Urban", mirëpo për shkak të keq menaxhimeve në atë ndërmarrje që kanë ndodhur, Komuna tash duhet me fonde të veta me paguar kredinë edhe tash prapë po kërkon kredi!

**Agim Gashi** luti kryesuesin që ta procedojë, pavarësisht a e merre voton a jo, në Kuvend kryetari ka të drejtë me e sjellë prapë propozimin, e aty është vendi ku duhet të debatojmë rrëth kësaj çështje.

**Agim Kuleta, kryesues**, tha se edhe unë propozoj të futet si pikë e rendit të ditës, diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit dhe në Kuvend votohet.

**Egzon Azemi** theksoi se KPF-ja e ka të drejtën e vetë, e aty ceket pastaj rekomandimi i KPF-së ka qenë mos me ardhur si pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi** e holli në votim, që të futet si pikë në rendin e ditës: "Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore".

**Eman Rahmani** tha se është mirë që këtij dokumentit me ia bashkëngjitur edhe certifikatën e pronës.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah futja në rend dite e pikës "Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore".

**Kryesuesi** e holli në votim që të futet si pikë në rendin e ditës kërkesa për kredi për rregullimin e ndërtesave publike për kulme, fasada, ndërtesa, eficiencë etj.

**Kryesuesi konstatoi se, më 4 vota për, 5 kundër dhe 1 abstenim, nuk futet si pikë e rendit të ditës.**

**Kryesuesi e holli në votim komplet rendin e ditës, me pikën që u shtua.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ky**

**REND I DITËS:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Informatë e Policisë së Kosovës rreth gjendjes së sigurisë në komunën e Prishtinës;**
- 3. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2019(TM3);**
- 4. Propozimvendimi për anëtarësim të Komunës së Prishtinës dhe kuota e anëtarësisë në shoqatën "Unioni i Bashkësive Shqiptare në Rajon";**
- 5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Feti (Hajredin) Gashit ;**
- 6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit ;**
- 7. Informatë për fillimin e vittit shkollor 2019 ;**
- 8. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksioneve në NPL "Kuzhina Qendrore" SHA , Prishtinë;**
- 9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore;**
- 10. Të ndryshme.**

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Pika e dytë**

**Informatë e Policisë së Kosovës rreth gjendjes së sigurisë në komunën e Prishtinës.**

**Agim Kuleta, kryesues**, tha se kjo është pikë e propozuar nga zotëri Agim Gashi.  
**Osman Bllaca** tha se kemi kontaktuar me komandantin e përgjithshëm të regjionit të Prishtinës, z. Fehmi Hotin, ata e përgatisin një raport dhe e lexojnë.  
**Eman Rahmani** shprehu mendimin se kishte qenë mirë që atë raport me na e dërguar paraprakisht me E-mail.

**Agim Gashi** theksoi se ajo është një informatë, si rezultat i bashkëpunimit në kontinuitet të Komunës së Prishtinës me Policinë e Kosovës, dhe nuk e kanë praktikuar asnjëherë me dërguar material paraprak. Ne duhet t'i pranojmë ashtu si janë, si vinë dhe si flasin, pastaj debatojmë dhe kritikojmë nëse ka vend.

### Pika e tretë

#### Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2019 (TM 3).

**Halim Halimi** theksoi se në reportin financier buxhetor për TM 3, shihet se sa i përket të hyrave, thuhet se të hyrat e tremujorit kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak, mirëpo duhet të dihet se të hyrat në buxhetin e Komunës grumbullohen më së shumti nga taksat për transaksion në pronë, infrastrukturë rrugore etj. Ky planifikimi i buxhetit për vitin 2019, në shumën prej 31 milionë euro, është një keqplanifikim, është dashtë planifikimi për të hyrat e Komunës së Prishtinës të jetë më i madh, ngase Komuna e Prishtinës ka resurse me grumbulluar edhe më shumë të hyra.

Brengosëse është performanca e shpenzimeve. Shpenzimet buxhetore në këtë tremujor kanë arritur në 18,334,188.38€, ku shpenzimet bëhen për paga dhe mëditje, shpenzimet në mallra dhe shërbime kanë shënuar një rritje prej 59.33%, shpenzime komunale kanë shënuar rritje 46.32%, shpenzimet në subvencione dhe transfere kanë shënuar rritje prej 170.35% dhe shpenzimet kapitale rritje prej 31.97%, kështu që realizimi i shpenzimeve kapitale te investimet kapitale nuk është aspak i kënaqshëm.

Nëse e analizojmë sipas drejtive, disa drejtori i kanë shpenzimet 0 % për 9 muaj të këtij viti dhe nuk di si mund ta arsyetojnë këtë! Ajo që është më shqetësuese, është tek shpenzimet kontingjente, d.m.th. borxhi i Komunës është gjithherë duke u rritur, që do të thotë se kështu nuk ka shpresë për përmirësim.

**Agim Gashi** tha se deri në mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit janë 7-8 ditë, e për me qenë rapporti sa më i saktë, do të ishte mirë që për pjesën e projekteve që deri më 30 shtator kanë pasur shpenzime 0, të ndahen dhe të sqarohen pse është kjo situatë, a janë projekte në procedurë të prokurimit, kontrata të lidhura dhe fillimi i kryerjes së punëve, d.m.th. të kategorizohen në dy - tri grupe, që ne ta kemi qartë një pasqyrë se cilat dhe në çfarë shkalle është duke u shpenzuar buxheti deri në fund të vitit.

Po ashtu tha se te subvencionet kemi ngritje 170%, por a ka hyrë edhe pagesa e kredisë për ndërmarrjen "Trafiku Urban" në subvencione, nëse jo, si është e mundur me u rritur aq shumë, në cilën fushë kanë shkuan.

**Eroll Raskova** dha sqarime, duke cekur se nuk kanë hyrë pagesat e kredisë së ndërmarrjes "Trafiku Urban", por këtu kanë qenë pagesat e një pjese të ndërmarrjes IMN "Kosova", ish-Tjegullorja, dhe "Pallatit të Rinisë".

**Eman Rahmani** shprehu mendimin se kishte qenë mirë me ardhur secili drejtor me prezantuar raportin për drejtorinë e vet se ku janë ngecjet, e jo vetëm drejtoresha e financave me raportua për të gjitha drejtoritë, se barrën dhe akuzat që ne po i bëjmë po i merr komplet drejtoresha, andaj është dashtë t'i dërgohet ftesë secilit drejtor, që të vije dhe të raportojë për drejtorinë e vetë.

**Eroll Raskova** tha se ne te këto raportet TM 3 paraqesim raportin real të të hyrave dhe të dalave, mirëpo në detale do të mund të informonin drejtorët e drejtorive, sepse janë në ngjarje dhe mund të kenë informacione më të plota.

**Sami Boroci** u shpreh se do të ishte mirë që kryesuesi me iu drejtuar të gjithë drejtorëve me një E-email, ku do të kërkonte nga drejtorët të marrin pjesë në seancën e Kuvendit, se ne mundemi me bërë pyetje specifike për drejtori të caktuara, e drejtoresha e financave ka problem me dhënë përgjigje në detaje lidhje më këto çështje.

**Halim Halimi** tha se kishte qenë mirë drejtorët me qenë këtu, ku do të na kishin sqaruar shumë çështje dhe ne nuk do të ishim marrë në Kuvend me këto çështje.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2019 (TM 3) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për anëtarësim të Komunës së Prishtinës dhe kuota e anëtarësisë në shoqatën "Unioni i Bashkësive Shqiptare në Rajon".**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për anëtarësim të Komunës së Prishtinës dhe kuota e anëtarësisë në shoqatën "Unioni i Bashkësive Shqiptare në Rajon" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Feti (Hajredin) Gashit.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Feti (Hajredin) Gashit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

### **Pika e shtatë**

**Informatë për fillimin e vitit shkollor 2019.**

**Shpresa Shala** tha se ne e kemi dërguar materialin në pika të shkurta se si ka filluar viti i ri shkollor në komunën e Prishtinës, duke i përfshirë trajnimet e mësimdhënësve, trajnimet e stafit mbështetës, regjistrimin në shkolla, por nuk e kemi raportin e detajuar, sepse tani i kemi marrë intervenimet që janë bërë në infrastrukturë, d.m.th. nuk i kemi bashkëngjitur në emra të shkollave se cilën shkollë është intervenuar, edhe pse disa kontrata ende nuk kanë kaluar, për shkak se ende janë projekte në procedurë në prokurim.

**Halim Halimi** shprehu mendimin se së pari është dashur të jepet informata përfundimin e vitit shkollor, që është shumë e arsyeshme, e sa i përket informatës e cila do të shkojë për Kuvend, do të diskutoj atje, se kam disa vërejtje në këtë informatë.

**Agim Gashi** tha se është mirë përfusha të ndjeshme, siç është arsimi, të ketë raporte periodike, se ne e dimë që informata ndryshon. Në këtë informatë mungojnë pasqyrat statistikore për të gjitha nivelet, se ndryshojnë statistikat prej vitit në vit sipas niveleve, sipas tipeve të shkollave, kështu që deri në Kuvend kishte qenë mirë me ia bashkëngjitur, po ashtu me ditur sa institucionet publike dhe private janë në komunën e Prishtinës. Me dhënë informacione se sa ka arritur Komuna e Prishtinës për kokë nxënësi të ketë hapësirë shkollore, është dashur të kemi informata edhe për disa probleme që i kemi pasur në shkollën teknike "28 Nëntori". Në shkollën "Elena Gjika" kemi pasur një helmim, ku ka operuar një operatorë në mënyrë të paligjshme. Është dashur me pasur informacione se a është kompletuar çështja e transportit të nxënësve, a janë krye disa obligime teknike që janë në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit. Edhe ato që i ceku drejtoresha, në fushën e investimeve, a janë përfshirë të gjitha institucionet në përgatitje teknike përfundimin e vitit, nëse jo, atëherë ku kanë qenë pengesat, a ka qenë pengës mungesa e buxhetit, apo ka qenë pengesë Zyra e prokurimit, apo faktorë të tjera procedural që përgatitin projekte përfundim të procedura të prokurimit me kohë etj.

**Eman Rahmani**, bëri të ditur se ka disa vërejtje sa i përket investimeve kapitale në kuadër të Arsimit. Shkollat nuk janë në gjendje të mirë, andaj ka nevojë përvijetimët e shumicën e shkollave. Sa u përket këtyre vonesave, mendoj këtu me u bërë planifikimi që me u kryer

punët gjatë pushimeve verore, në mënyrë që të mos pengohen nxënësit, punët kryhen më shpejt prej donatorëve, por duhet me u paraparë çdo herë që kompanitë që fitojnë tenderin, këto procedurat zgjaten dhe këtë duhet me shti në pjesë të planifikimit edhe këtë kohën të cilën ju po e quani si vonesë.

**Egzon Azemi** i parashtroi pyetje drejtoreshës rrëth çështjes së shkollës "Ahmet Gashi", se a është përzgjedhur grupi i ekspertëve, çka ka ndodhur dhe a kanë fillua me bërë vlerësimin.

**Shpresa Shala** tha se për shkolla "Ahmet Gashi" janë dakorduar me kryetarin që me caktuar ata një komision. Ata i kanë dërguar emrat dhe së shpejti pritet me filluar me bërë vlerësimin, por duhet me qenë edhe një anëtar i Komunës aty kur të bëhet ekspertiza.

**Egzon Azemi** pyeti se a ka marrë leje nga Komuna KQZ-ja për shfrytëzimin e atij objekti, me gjithë rrezikun, që unë nuk besoj se është në atë nivel të rrezikut siç e kanë paraqitur në fillim. Ai objekt është shfrytëzuar edhe për trajnimin e vëzhgueseve, e komisioneve te KQZ-së dhe si qendër votimi, çka për një objekt të tillë nëse ka rrezik për të cilin është folur, atëherë nuk do të duhej të lejohej një gjë e tillë.

**Shpresa Shala** theksoi se nuk ka marrë leje nga ne, ka biseduar me kryetarin, por kryetari ka kërkuar që ata me bërë një deklaratë dhe me marrë përgjegjësin për të gjitha rreziqet eventualisht që mund të ndodhin. Ekziston dokumenti që thotë se shkolla është në atë gjendje që ka rrezikshmëri për nxënës.

**Agim Gashi**, sa për informatë, tha se ndoshta shumë këshilltarë nuk e dinë që shkolla "Ditët e Minatorit" është në territorin e Komunës së Graçanicës dhe Komuna e Graçanicës e ka zëvendëskryesuesin shqiptar, ka këshilltarë në asamblenë komunale, ka drejtorë shqiptarë, andaj është mirë me ia bërë me dije Qeverisë së Kosovës, se Komuna e Prishtinës që tash e tutje nuk merr barrë për një institucion, pavarësisht a janë shqiptarë, serb, apo rom, se janë qytetarë të Kosovës, dhe nuk merr barrë më tutje se shkolla nuk paska mundësi me qenë në administrimin e Komunës së Graçanicës, ndërsa toka dhe pasuritë tjera po, dhe kur nuk trajtohet Komuna e Prishtinës, atëherë pse Qeveria e Kosovës ia qet buxhetin Komunës së Prishtinës për ata arsimtarë dhe barrën e merr Komuna e Prishtinës. Këtë informacion është mirë me ia dhënë Kuvendit të Komunës së Prishtinës, se nuk e dinë njerëzit se ajo i takon Komunës së Graçanicës.

#### Pika e tetë

**Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksioneve në NPL "Kuzhina Qendrore" SHA, Prishtinë.**

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksioneve në NPL "Kuzhina Qendrore" SHA, Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.



## Pika e nëntë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

*Mbledhja përfundoi në orën 10:55.*

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta

